



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

ELEKTROTEKNIKË

Niveli IV në KSHK¹, referuar niveli IV të KEK²

E-IV-25

Tiranë, 2025

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kohëzgjatja	4
Niveli	4
Qëllimi:	4
Ofruesit	4
Data e validimit	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT	5
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	5
NjN-05-IV-0255-25 Planifikimi dhe organizimi i punës në elektroteknikë	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
NjN-05-IV-0256-25 Instalimi i sistemeve për furnizimin e pandërprerë me energji	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	8
Kriteret e vlerësimit	8
NjN-05-IV-0257-25 Mirëmbajtja dhe riparimi i sistemeve dhe pajisjeve elektrike	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	11
NjN-05-IV-0258-25 Matja e parametrave elektrike dhe mekanike	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	12
NjN-05-IV-0259-25 Cilësia e punimeve elektrike	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	13
Kriteret e vlerësimit	13
NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	14
Kriteret e vlerësimit	14
NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	15
Kriteret e vlerësimit	15

NjN-05-IV-0260-25 Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në elektroteknikë.....	16
Rezultatet e të nxënit në njohuri	16
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	16
Kriteret e vlerësimit	17
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	17
Modalitetet e vlerësimit.....	17
Informacion shtesë	18
SHËNIM.....	18

Emërtimi i kualifikimit	ELEKTROTEKNIKË			Kodi E-IV-25
	Kohëzgjatja	1500 orë nocionale	Niveli Niveli IV i KSHK, referuar niveli IV të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Elektroteknikë”, Niveli IV KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar si teknik elektrik në veprimtaritë profesionale që lidhen me elektroteknikën.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional “Elektroteknike”, niveli IV i KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> -kanë mbaruar arsimin profesional në një nga kualifikimet e nivelit III të KSHK-së, referuar nivelit III të KEK, në “Elektroteknikë”. - janë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryerjen e detyrës për përballimin e kërkesave të këtij niveli të arsimit profesional; - pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Elektroteknikë”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të këtij niveli si teknik/menaxher i mesëm në këtë kualifikim profesional.</p> <p>Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në sektorin elektroenergjitik përfshirë energjitë e rinovueshme (prodhim, transmetim, shpërndarje), në sektorë të ndryshëm të industrisë, punime civile, në njësi të shërbimeve elektrike, në instalime elektrike të ndryshme, në shërbime të riparimeve e mirëmbajtjes së pajisjeve, si dhe në njësi të tjera ekonomike që ushtrojnë veprimtarinë në drejtimin e sistemeve elektroteknike, elektronike apo komponentëve të tyre përbërës. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në këtë fushë.</p> <p>Me përfundimin e kualifikimit profesional “Elektroteknikë”, niveli IV në KSHK, ai/ajo fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	Korrik 2025			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	E-IV-15; E-IV-21			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “**Elektroteknikë**”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
3. Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
7. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
8. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gatishmëri dhe vullnet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
9. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
10. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.
11. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
12. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
13. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
14. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës proaktiv në grup;
15. Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
16. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
17. Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
18. Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
19. Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme,

njohuri dhe shprehi profesionale).

NjN-05-IV-0255-25 Planifikimi dhe organizimi i punës në elektroteknikë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë mënyrën e organizimit të sektorit energjetik dhe strukturën e ndërmarrjeve/biznesit;
2. Të përshkruajë strukturat organizative të kompanisë dhe komunikimin hierarkik;
3. Të shpjegojë skemat dhe simbolet në dokumentacionin teknik;
4. Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit të grafikut të punimeve;
5. Të përshkruajë llojet e mjeteve dhe pajisjeve të punës, funksionimin dhe përdorimin e tyre;
6. Të përshkruajë llojet e materialeve, karakteristikat dhe përdorimin e tyre;
7. Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e planifikimit të burimeve njerëzore;
8. Të përshkruajë proceset e punës dhe elementët përbërës të tyre;
9. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
10. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së vendit të punës;
11. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së pastrimit dhe sistemimit të vendit të punës;
12. Të shpjegojë rëndësinë e organizimit ergonomik të vendit të punës;
13. Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e menaxhimit të kohës;
14. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e përgatitjes së urdhrit të punës;
15. Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e bashkëpunimit me specialistë të tjerë;
16. Të përshkruajë formatet e dokumentimit të punës;
17. Të përshkruajë mënyrat e raportimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të organizojë punën në sektorin energjetik;
2. Të menaxhojë burimet materiale;
3. Të menaxhojë burimet njerëzore;
4. Të kryejë dokumentimin dhe raportimin e punës së kryer në sektorin energjetik.

Kriteret e vlerësimit

- Organizon një ndërmarrje/biznes në sektorin energjetik, sipas strukturës së nevojshme;
- Komunikon sipas hierarkisë së strukturave organizative të kompanisë;
- Zbërthen skemat dhe simbolet në dokumentacionin teknik, sipas projektit dhe specifikimeve teknike;
- Mbikëqyr organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike;
- Planifikon mjetet, materialet dhe pajisjet e nevojshme, sipas projektit dhe specifikimeve teknike;
- Kontrollon përdorimin e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të nevojshme, sipas specifikimeve teknike;

- Kontrollon gatishmërinë për punë të mjeteve, materialeve dhe pajisjeve, sipas specifikimeve teknike;
- Planifikon proceset e punës sipas prioriteteve;
- Planifikon burimet e nevojshme njerëzore, sipas detyrave dhe kualifikimeve;
- Menaxhon burimet e nevojshme njerëzore, sipas detyrave dhe kualifikimeve;
- Përgatit urdhrin e punës, sipas procesit të planifikuar;
- Mbikëqyr zbatimin e proceseve të punës sipas detyrës;
- Kontrollon realizimin e punës në kohë sipas grafikut;
- Mbikëqyr pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës sipas rregullit;
- Merr informacion të saktë dhe të plotë mbi strukturat e organizatës dhe rregulloret e brendshme të saj;
- Bashkëpunon me specialistë të tjerë sipas detyrës;
- Dokumenton punën e kryer sipas formateve të aprovuara;
- Raporton në kohën e duhur tek eprorët.

NjN-05-IV-0256-25 Instalimi i sistemeve për furnizimin e pandërprerë me energji

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të analizojë projektin elektrik të sistemeve të furnizimit me energji elektrike;
2. Të argumentojë përdorimet e sistemeve elektrike civile dhe industriale të furnizimit me energji;
3. Të shpjegojë komponentët elektrikë të sistemeve të furnizimit me energji elektrike dhe simbolet përkatëse;
4. Të shpjegojë procedurën e instalimit të komponentëve të impianteve elektrike;
5. Të argumentojë domosdoshmërinë e zbatimit të kushteve teknike gjatë instalimit të sistemeve të furnizimit me energji elektrike;
6. Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të plan vendosjes së pajisjeve të sistemit përkatës të furnizimit;
7. Të përshkruajë elementët dhe tipet e strukturës ku do të montohet impianti përkatës i furnizimit me energji elektrike;
8. Të analizojë elementët përbërës të një impianti shpërndarës të energjisë elektrike;
9. Të analizojë karakteristikat e impianteve të energjisë së rinovueshme;
10. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së instalimit/montimit të impianteve të energjisë së rinovueshme;
11. Të analizojë skemat elektrike të furnizimit me energji elektrike;
12. Të analizojë skema të thjeshta të automatizuara për sisteme të furnizimit të pandërprerë me energji elektrike;
13. Të përshkruajë llojet dhe funksionin e UPS dhe baterive akumulatore;
14. Të analizojë karakteristikat për ndërtimin e rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm elektrik;

15. Të shpjegojë procedurën e instalimit të rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm elektrik;
16. Të shpjegojë rëndësinë e elementeve të mbrojtjes të sistemeve të furnizimit të pandërprerë me energji elektrike;
17. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të manualeve të pajisjeve të sistemeve elektrike;
18. Të analizojë përdorimin e skemave të ndryshme të instalimit të ndriçimit dhe fuqisë në objekte civile dhe industriale;
19. Të shpjegojë procedurën e instalimit të kuadrit elektrik dhe pajisjeve mbrojtëse;
20. Të përshkruajë teknikat e etiketimit dhe rëndësinë e tyre;
21. Të shpjegojë llojet dhe mënyrën e realizimit të tokëzimit, nulifikimit mbrojtës dhe shkarkimeve atmosferike;
22. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së instalimit/montimit të sistemeve të furnizimit me energji elektrike;
23. Të argumentojë rëndësinë e kryerjes së provave pa ngarkesë dhe me ngarkesë të rrjetit të furnizimit me energji elektrike;
24. Të shpjegojë procedurat e testimit dhe certifikimit për sistemet elektrike;
25. Të përshkruajë karakteristikat e sistemeve elektromekanike;
26. Të përshkruajë elementët përbërës të pajisjeve elektroshtëpiake;
27. Të analizojë elementet e një transmisioni elektrik;
28. Të analizojë karakteristikat elektrike të motorëve elektrikë;
29. Të shpjegojë mënyrat e rregullimit të shpejtësisë në transmisionet elektrike;
30. Të analizojë procese të ndryshme industriale;
31. Të shpjegojë modelimin dhe simulimin e një procesi industrial të thjeshtë;
32. Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të aplikacioneve për krijimin dhe përditësimin e skemave elektrike.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të mbikëqyrë instalimin e komponentëve të impiantit përkatës;
2. Të mbikëqyrë instalimin e kuadrit elektrik dhe pajisjeve mbrojtëse;
3. Të mbikëqyrë zbatimin e procedurës së lidhjes së impianteve të rrjetit elektrik;
4. Të përdorë modelimin dhe simulimin për analizimin e një procesi industrial;
5. Të përdorë aplikacione kompjuterike për krijimin dhe përditësimin e skemave elektrike;
6. Të mbikëqyrë instalimin e sistemeve elektromekanike;
7. Të mbikëqyrë instalimin e pajisjeve elektroshtëpiake;
8. Të zbatojë procedurat e testimit dhe certifikimit për sistemet elektrike.

Kriteret e vlerësimit

- Analizon saktë projektin elektrik të sistemeve të furnizimit me energji elektrike;
- Analizon saktë skemat elektrike, diagramat e lidhjeve për instalimin, kontrollin, funksionimin, mirëmbajtjen e sistemeve elektrike;
- Kontrollon përputhshmërinë e projektit me strukturën fizike të objektit sipas specifikimeve të

projektuesit;

- Kontrollon në mënyrë vizuale vendosjen mekanike të pajisjeve, mbështetur në projekt;
- Mbikëqyr realizimin saktë të punimeve elektrike në terren sipas projektit të zbatimit dhe referencave;
- Mbikëqyr instalimin e linjave të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë sipas projektit të zbatimit;
- Kontrollon realizimin e instalimeve elektrike civile dhe industriale sipas projektit dhe rregulloreve të instalimeve;
- Mbikëqyr zbatimin e saktë të procedurës së instalimit të komponentëve të impianteve elektrike;
- Mbikëqyr instalimin e UPS dhe baterive akumulatore sipas udhëzimeve teknike dhe manualeve;
- Ndjek instalimin e gjeneratorit sipas manualeve përkatëse;
- Ndjek instalimin e panelit të komutimit të burimeve të ndryshme të energjisë sipas projektit;
- Mbikëqyr instalimin e sistemit të matjes së energjisë elektrike sipas udhëzimeve teknike;
- Mbikëqyr instalimin e impiantit të tokëzimit, nulifikimit mbrojtës dhe shkarkimeve atmosferike duke siguruar vlerat e rezistencave sipas rregulloreve përkatëse;
- Mbikëqyr realizimin e instalimit të ndriçimit dhe fuqisë në objekte civile dhe industriale sipas skemave të ndryshme të dhëna në projekt;
- Mbikëqyr instalimin sipas kushteve teknike të rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm elektrik;
- Mbikëqyr zbatimin me korrektësi të procedurës së instalimit të kuadrove elektrik dhe pajisjeve mbrojtëse;
- Kontrollon saktësinë e etiketimit gjatë instalimeve elektrike;
- Mbikëqyr realizimin e matjeve të nevojshme për kontrole paraprake të impiantit përkatës;
- Kontrollon integrimin e sistemeve elektromekanike sipas projektit dhe manualeve;
- Ndjek zbatimin e teknikave të instalimit të elementeve përbërës të pajisjeve elektroshtëpiake;
- Kontrollon elementet përbërës të një transmisioni elektrik sipas linjës teknologjike;
- Kontrollon motorët elektrikë sipas parametrave elektrikë të tyre;
- Zbaton teknikat e rregullimit të shpejtësisë në transmisionet elektrike;
- Analizon procese të ndryshme industriale duke përdorur metodat e modelimit dhe simulimit;
- Siguron zbatimin me rigorizitet të kushteve teknike gjatë instalimit të sistemeve të furnizimit me energji elektrike;
- Kontrollon zbatimin me përpikëri të udhëzimeve të manualeve të përdorimit të pajisjeve elektrike;
- Evidenton në kohë dhe saktë problemet teknike që mund të lindin gjatë zbatimit të projektit;
- Përditëson skemat elektrike me ndryshimet përkatëse, referuar standardeve;
- Koordinon rregullisht me inxhinierët dhe projektuesit për modifikimet e mundshme të projektit;

- Përdor aplikacione kompjuterike për krijimin dhe përditësimin e skemave elektrike;
- Asiston në kryerjen e provave pa dhe me ngarkesë të impianteve, rrjetit të furnizimit me energji elektrike;
- Asiston në testimet përfundimtare dhe certifikimin e sistemit sipas standardeve.

NjN-05-IV-0257-25 Mirëmbajtja dhe riparimi i sistemeve dhe pajisjeve elektrike

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e njohjes së sistemeve elektrike dhe të pajisjeve, ku do të kryhen kontrole, mirëmbajtje dhe riparime;
2. Të shpjegojë rëndësinë e hartimit të grafikut të mirëmbajtjes periodike sipas manualeve përkatëse;
3. Të shpjegojë rëndësinë e kontroleve periodike dhe mirëmbajtjes në sisteme elektrike dhe në pajisje;
4. Të shpjegojë rëndësinë e testimit dhe matjeve pas riparimit të impiantit elektrik;
5. Të shpjegojë llojet e matjeve të parametrave në sisteme dhe pajisjeve elektrike;
6. Të klasifikojë llojet e mjeteve dhe materialeve të përshtatshme për pastrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe pajisjeve elektrike;
7. Të klasifikojë llojet e aparateve dhe pajisjeve të nevojshme për shërbimet e kontrollit;
8. Të analizojë teknikat për kontrollin e mirëmbajtjes së impianteve elektrike, linjave të tensionit të ulët, mesëm dhe të lartë;
9. Të klasifikojë llojet e materialeve të grasatimit dhe vajosjes në impiante elektrike dhe teknikat përkatëse;
10. Të shpjegojë rëndësinë e shërbimeve periodike të mirëmbajtjes;
11. Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të procesit të mirëmbajtjes, riparimit dhe raportimit;
12. Të analizojë llojet e defekteve të impianteve elektrike dhe sistemeve elektromekanike;
13. Të përshkruajë llojet e dëmtimeve fizike të pajisjeve elektrike;
14. Të përshkruajë teknikat e çmontimit dhe montimit të pajisjeve në sisteme elektrike;
15. Të përshkruajë teknikat e riparimit dhe të zëvendësimit në pajisje dhe sisteme elektrike;
16. Të shpjegojë rëndësinë e testimit pas riparimit/zëvendësimit dhe mirëmbajtjes;
17. Të shpjegojë rëndësinë e verifikimit në mënyrë periodike dhe teknikat e kontrollit të rezistencës së tokëzimit, nulifikimit mbrojtës dhe shkarkimeve atmosferike në sisteme dhe pajisje elektrike.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë kontrole periodike të sistemit elektrik dhe pajisjeve;
2. Të mbikëqyrë shërbimet periodike të mirëmbajtjes së sistemit elektrik dhe pajisjeve;
3. Të mbikëqyrë riparimet e pjesëve të dëmtuara në sistemin elektrik dhe pajisje;
4. Të mbikëqyrë zëvendësimet e komponentëve të sistemit elektrik dhe pajisjeve në rast dëmtimi të tyre;

5. Të asistojë në kontrollet periodike të matjes së rezistencës së tokëzimit në impiante;
6. Të dokumentojë kontrollet dhe shërbimet e kryera.

Kriteret e vlerësimit

- Harton grafikun e mirëmbajtjes periodike sipas manualeve përkatëse;
- Kryen kontrolle periodike dhe mirëmbajtje në sistemet elektrike dhe në pajisje;
- Kryen testime dhe matje pas riparimit të impiantit elektrik;
- Mbikëqyr matjet e parametrave në sistemet elektrike dhe pajisjeve;
- Planifikon mjetet dhe materialet e përshtatshme për pastrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektrike dhe pajisjeve;
- Përdor aparate dhe pajisje të nevojshme për shërbimet e kontrollit;
- Zbaton teknika për kontrollin e mirëmbajtjes së impianteve elektrike, linjave të tensionit të ulët, mesëm dhe të lartë;
- Porosit materiale për grasatimin dhe vajosjen e impianteve elektrike sipas teknikave përkatëse;
- Dokumenton procesin e mirëmbajtjes, riparimit dhe raportimit sipas procedurës;
- Identifikon llojet e defekteve të impianteve elektrike dhe sistemeve elektromekanike;
- Dallon llojet e dëmtimeve fizike të pajisjeve elektrike;
- Mbikëqyr çmontimin dhe montimin e pajisjeve elektrike në sisteme elektrike dhe pajisje;
- Përdor teknika të riparimit dhe të zëvendësimit në sisteme elektrike dhe pajisje;
- Mbikëqyr testime pas riparimit/zëvendësimit dhe mirëmbajtjes;
- Mbikëqyr verifikimin në mënyrë periodike dhe teknikat e kontrollit të rezistencës së tokëzimit në sisteme elektrike dhe në pajisje.

NjN-05-IV-0258-25 Matja e parametrave elektrike dhe mekanike

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të klasifikojë parametrat elektrike dhe magnetike;
2. Të përshkruajë mënyrat e matjes së parametrave elektrike dhe magnetike;
3. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e kryerjes së kontrollit të izolacionit;
4. Të përshkruajë mënyrat e matjes së rezistencës së tokëzimit;
5. Të përshkruajë mënyrat e matjeve të baterive;
6. Të shpjegojë rëndësinë e leximit të manualeve të aparateve matëse;
7. Të listojë standardet kryesore teknike shqiptare që duhet të zbatohen në instalimet elektrike civile dhe industriale;
8. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të standardeve dhe udhëzimeve teknike për matjet elektrike;
9. Të përshkruajë llojet e instrumenteve matëse kontrolluese dhe mënyrat e përdorimit të tyre;
10. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të aparateve të kalibrimit;
11. Të përshkruajë mënyrat e matjes së temperaturës së kontakteve;
12. Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të procesit të matjeve.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të mbikëqyrë matjet e parametrave elektrike dhe magnetike;
2. Të mbikëqyrë matjet e rezistencës së tokëzimit dhe baterive;
3. Të mbikëqyrë matjen e kontrollit të izolacionit të kabllave;
4. Të mbikëqyrë matjet e temperaturës së kontakteve;
5. Të dokumentojë procesin e matjeve.

Kriteret e vlerësimit

- Analizon parametrat elektrike dhe magnetike, sipas standardeve teknike;
- Mbikëqyr përdorimin e instrumenteve matëse, sipas manualit të përdorimit;
- Mbikëqyr matjet e parametrave elektrike dhe magnetike, sipas udhëzimeve teknike;
- Mbikëqyr kontrollin e izolacionit të kabllave, sipas udhëzimeve teknike;
- Mbikëqyr matjen e rezistencës së tokëzimit, sipas udhëzimeve teknike;
- Mbikëqyr matjen e baterive, sipas udhëzimeve teknike;
- Mbikëqyr matjen e temperaturës së kontakteve, sipas udhëzimeve teknike;
- Mbikëqyr kalibrimin e aparateve, sipas udhëzimeve teknike;
- Dokumenton rregullisht procesin e matjeve.

NjN-05-IV-0259-25 Cilësia e punimeve elektrike

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të standardeve për sigurimin e cilësisë në instalime elektrike;
2. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të materialeve dhe pajisjeve sipas normave dhe standardeve në fuqi;
3. Të analizojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së instalimeve të rrjetit të furnizimit me energji elektrike;
4. Të përshkruajë llojet e etiketimit të linjave;
5. Të analizojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së instalimeve të linjave të furnizimit të pajisjeve dhe makinerive;
6. Të analizojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së instalimeve të rrjeteve të ndriçimit të jashtëm dhe të brendshëm të objektit industrial dhe civil;
7. Të analizojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së instalimeve të sistemeve të sinjalizimeve;
8. Të analizojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së instalimeve të paneleve të matjes, mbrojtjes dhe komandimit;
9. Të analizojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së instalimeve të impiantit të tokëzimit, nulifikimit dhe mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike;
10. Të analizojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së impianteve të furnizimit të pandërprerë me energji elektrike;

11. Të shpjegojë rëndësinë e kryerjes së testeve për funksionimin e pajisjeve të instaluara.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kontrollojë cilësinë e materialeve të përdorura;
2. Të kontrollojë cilësinë e punimeve të kryera.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh materiale cilësore në përputhje me standardet teknike;
- Kontrollon cilësinë e materialeve të përdorura sipas standardeve;
- Kontrollon cilësinë e instalimeve të rrjetit të furnizimit me energji elektrike sipas standardit;
- Kontrollon markimin e linjave sipas projektit;
- Kontrollon cilësinë e instalimeve të linjave të furnizimit të pajisjeve dhe makinerive;
- Kontrollon cilësinë e instalimeve të rrjetit të ndriçimit të brendshëm dhe të jashtëm të objektit industrial, sipas standardit;
- Kontrollon cilësinë e instalimeve të sistemeve të sinjalizimeve, sipas standardit;
- Kontrollon cilësinë e instalimeve të paneleve të matjes, mbrojtjes dhe komandimit, sipas standardit;
- Kontrollon cilësinë e instalimeve të impiantit të tokëzimit dhe mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike, sipas standardit;
- Kontrollon cilësinë e instalimit të impianteve të energjisë së rinovueshme, sipas standardit;
- Kontrollon cilësinë e instalimit të panelit të komutimit të burimeve të ndryshme të energjisë, sipas standardit;
- Kontrollon cilësinë e instalimit të gjeneratorit, baterisë akumulatore dhe UPS, sipas standardit.

NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit tatimor dhe kodin e punës në fuqi;
2. Të përshkruajë llojet e dokumentacioneve administrative dhe ekonomike në sektorin e furnizimit me energji elektrike dhe rëndësinë e përpilimit dhe arkivimit të tyre;
3. Të shpjegojë mënyrën e hartimit të planeve ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
4. Të shpjegojë rëndësinë e informimit për çmimet dhe cilësinë e mjeteve dhe materialeve të punës;
5. Të përshkruajë elementët e llogaritjes së kostos së mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës, si dhe çmimit të një produkti/shërbimi;
6. Të përshkruajë mënyrën e plotësimit të faturave sipas llojit të tyre;
7. Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së një oferte për produktet/shërbimin që do të ofrojë;
8. Të shpjegojë llojet e dokumenteve për dorëzimin e shërbimeve/produkteve dhe mënyra e

- përgatitjes së tyre;
9. Të shpjegojë rëndësinë e marrjes së informacionit nga tregu lidhur me çmimet, llojet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve;
 10. Të shpjegojë mënyrën e ruajtjes së dokumentacioneve teknik dhe financiar;
 11. Të përshkruajë procedurat për fillimin e një biznesi dhe regjistrimin e tij;
 12. Të përshkruajë teknikat e marketingut;
 13. Të përshkruajë rolin e bashkëpunëtorëve në veprimtarinë profesionale dhe parimet e punës në grup;
 14. Të argumentojë rëndësinë e ndjekjeve të trajnimeve dhe kurseve profesionale në zhvillimin profesional dhe në karrierë;
 15. Të përshkruajë mënyrat e transmetimit të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë tek bashkëpunëtorët;
 16. Të shpjegojë domosdoshmërinë e pjesëmarrjes në panaire dhe ekspozita për energjinë;
 17. Të shpjegojë rëndësinë e studimit të literaturës bashkëkohore;
 18. Të analizojë rëndësinë e vlerësimit të vetvetes.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë legjislacionin tatimor dhe kodin e punës në fuqi;
2. Të hartojë preventivat dhe situacionet në sipërmarrje në sistemet e furnizimit me energji elektrike;
3. Të zbatojë teknikat e marketingut;
4. Të kryejë trajnime të vazhdueshme për rritjen profesionale në sektorin e furnizimit me energji elektrike.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionin tatimor dhe kodin e punës në fuqi;
- Harton llojet e dokumentacioneve administrative dhe ekonomike, sipas procedurave;
- Plotëson saktë planet periodike të punës, në përputhje me detyrat;
- Regjistron sistematikisht të dhënat për ofertat dhe faturat e lëshuara klientëve;
- Merr periodikisht informacion nga tregu lidhur me çmimet, llojet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve;
- Kryen llogaritje të sakta të kostos së mjeteve, materialeve dhe pajisjeve, si dhe shërbimeve të kryera në bazë të projektit të dhënë;
- Dokumenton konsumimin e materialeve sipas procesit të punës;
- Përgatit saktë oferta për punimet/shërbimet që do të kryejë;
- Kryen blerje të mjeteve, materialeve dhe pajisjeve sipas projektit.
- Llogarit saktë çmimin përfundimtar për punimet/shërbimet e ofruara;
- Plotëson në kohë procesverbalin/dokumentin e dorëzimit të porosisë te klienti për punimet e kryera;

- Zbaton teknikat e duhura të marketingut për punimet/shërbimet që kryen;
- Monitoron inventarin për të siguruar disponueshmërinë e materialeve dhe pajisjeve sipas referencave dhe rregulloreve përkatëse;
- Identifikon metodat e përshtatshme për zhvillimin profesional, sipas nevojave;
- Organizon trajnime profesionale për stafin për përgatitje me praktikat më të mira të industrisë sipas nevojës;
- Bashkëpunon në veprimtarinë profesionale, sipas parimeve të punës në grup;
- Kryen trajnime dhe kurse profesionale, sipas teknologjisë bashkëkohore;
- Transmeton në kohë njohuritë dhe teknikat e reja në punë tek bashkëpunëtorët;
- Ndjek periodikisht panairë dhe ekspozita për energjinë;
- Përdor rregullisht literaturë bashkëkohore.

NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e informimit për problematikat dhe të rejat e ditës;
2. Të përshkruajë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe joverbal;
3. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kodit të etikës;
4. Të përshkruajë parimet e punës në grup;
5. Të përshkruajë teknikat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
6. Të përshkruajë llojet e aktorëve/bashkëpunëtorëve dhe rolin e tyre në veprimtarinë profesionale;
7. Të përshkruajë teknikat e motivimit;
8. Të shpjegojë rëndësinë e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në komunikimin me të tretët;
9. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale gjatë kryerjes së punës;
10. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të parimeve të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë teknikat e komunikimit;
2. Të zbatojë kodin e etikës në komunikimin me të tjerët;
3. Të përdorë terminologji profesionale gjatë komunikimit.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton rregulloren e organizatës në punë dhe në komunikim;
- Merr vazhdimisht informacione për detyrat dhe të rejat e ditës;
- Zbaton rregullat e vendit të punës dhe të higjienës personale;
- Zbaton parimet e punës në grup;

- Bashkëpunon me eprorët dhe kolegët, sipas detyrës;
- Zbaton rregullat e mirësjelljes në komunikim;
- Zbaton parimet e etikës profesionale;
- Zgjidh ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët, duke zbatuar teknikat përkatëse;
- Përdor teknologjitë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit me të tjerët;
- Përdor terminologjinë profesionale, sipas rregullave të komunikimit.

NjN-05-IV-0260-25 Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në elektroteknikë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë standardet dhe legjislacionin shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
2. Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
3. Të shpjegojë domosdoshmërinë e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
4. Të interpretojë manualat e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
5. Të përshkruajë dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti;
6. Të përshkruajë masat mbrojtëse në varësi të punës që do kryhet për mbrojtjen nga rënia nën tension në instalimet dhe pajisjet elektrike;
7. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të sinjalistikës në mjediset e punës;
8. Të përshkruajë planin e largimit në raste emergjence;
9. Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
10. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
11. Të identifikojë dhe raportojë tek personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
12. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të procedurave për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
13. Të shpjegojë rëndësinë e depozitimit të mbetjeve të punës;
14. Të përshkruajë rregullat për magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
15. Të llogarisë në mënyrë racionale përdorimin e energjisë dhe materialeve;
16. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
17. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të protokolleve në raste të gjendjes së jashtëzakonshme;
18. Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit nga ndikimi i fushave magnetike dhe elektrostatische dhe masat përkatëse për eliminimin e tyre;
19. Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndikimit në trupin e njeriut të fushave magnetike dhe elektrostatische dhe masat përkatëse për eliminimin e tyre.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës;
2. Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti;
3. Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Kriteret e vlerësimit

- Mbikëqyr/zbaton rregullat e sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Interpreton manualat e mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas standardit;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë punës në tension dhe lartësi;
- Jep ndihmën e parë në rast aksidenti, sipas procedurës;
- Mbikëqyr zbatimin e sinjalistikës në mjediset e punës, sipas rregulloreve;
- Mbikëqyr/zbaton planin e evakuimit në raste emergjence;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave përkatëse të përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
- Komunikon me personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- Mbikëqyr depozitimin e mbetjeve të punës;
- Mbikëqyr magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Përdor në mënyrë racionale energjinë dhe materialet;
- Zbaton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Zbaton protokollet në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i punës në elektroteknikë	10	NjN-05-IV-0255-25
2	Instalimi i sistemeve për furnizimin e pandërprerë me energji	25	NjN-05-IV-0256-25
3	Mirëmbajtja dhe riparimi i sistemeve dhe pajisjeve elektrike	20	NjN-05-IV-0257-25
4	Matja e parametrave elektrike dhe mekanike	15	NjN-05-IV-0258-25
5	Cilësia e punimeve	10	NjN-05-IV-0259-25
6	Sipërmarrje dhe edukim karriere	6	NjN-23-IV-0005-24
7	Komunikimi dhe etika profesionale	5	NjN-22-IV-0006-24
8	Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në elektroteknikë	9	NjN-02-IV-0260-25
		100 %	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kritereve të caktuara.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN-së për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të specifikuar. Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen te integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit. Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikant profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- d) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- e) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- f) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **E-IV-25**

E - Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

IV - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK -së

25 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-05-IV-0255-25**

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

05 – Numri që identifikon fushën e Njësive të të Nxënit

IV – Shifra që tregon nivelin e Njësive të të Nxënit në strukturën e KSHK-së

0255 – Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit

